



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

*SHESHI "NËNË TEREZA", REKTORATI I UT-së, TIRANË
TEL. +4 2228402, FAX: +4 223981*

VENDIM

Nr. 18 datë 13. 07. 2016

"Mbi përcaktimin e nivelit të njohje së gjuhës së huaj si kriter pranimit në ciklin e dytë të studimeve "Master i shkencave"

Bazuar në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSHP" neni 3 pika 4 gërma b), neni 38 pika 1 gërma a), neni 76 pika 4, neni 135; në Statutin e Universitetit të Tiranës neni 20 e neni 49 pikat 1.3 dhe 2.1; në Udhëzimin Nr.52 datë 03.12.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve "Për përcaktimin e nivelit të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë" pika 3, si dhe duke mbajtur parasysh propozimet e përcjella deri në datën 12.07.2016 nga njësitë kryesore të UT-së, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 13.07.2016;

VENDOSI:

1. Përcaktimin e nivelit B1 të njohjes së një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, si kriter pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" në Universitetin e Tiranës.
2. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe nivelet e njohjes së gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht) në pikë sipas testeve ndërkombëtare do të jetë sipas Tabelës 1 të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve "Për përcaktimin e nivelit të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë".
3. Ky kriter do të zbatohet për pranimet në të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" në vitin akademik 2016-2017, e në vijim.
4. Ngarkohen të gjitha njësitë kryesore të Universitetit të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
MNYR KONI**

